

## **AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE "House of Colors" sh.p.k**

Tiranë, më datë 24/02/2021

### **NENI 1**

Shoqëria Tregtare "House of Colors" sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

### **NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "House of Colors" sh.p.k

### **NENI 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme:

Prodhimin, import eksport, tregtimin me shumicë dhe pakicë të bojrave të ndryshme për lyerje në fushën e ndërtimeve civile dhe çdo sektor ku gjen aplikim përdorimi i bojrave si dhe të materialeve të ndërtimit apo të makinerive. Import eksport të artikujve të ndryshëm industrialë, hidrosanitare, artikuj te konsumit te gjerë, produkte gjysëm të gatshme, mjete dhe artikuj pune në fushën e ndërtimit. Ndërtimi i objekteve të ndryshme civile dhe industriale dhe riparimin e tyre. Shërbim transporti për të tretë. Punime të ndryshme dhe riparime në fushën e ndërtimit (suvatime,lyerje,izolime).

### **NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Selinë e Vjetër, pallati Brari, kulla 1, kati 0.

### **NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali ndahet në tre (3) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

**1. Z. Faik Gërxhi**, lindur në Berat më 17.12.1982 , shtetas Italian me vendëbanim Via Giovanni Marrati nr.80/2 Modena Itali , mbajtës i Kartë Identiteti me nr. AX5423717, zotëron zotëron 25% (njëzetë e pesë përqind)të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (25 000, njëzetë e pesë mijë) lekë.

**2. Z. Ilir Qafa**, lindur në Berat më 09.06.1978, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. 033276346, zotëron 50% (pesëdhjetë përqind) të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (50 000, pesëdhjetë mijë ) lekë.



**3. Z. Marjon Gorica**, lindur në Tiranë më 01.02.1995 shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. 032043718, zotëron 25% (njëzetë e pesë përqind)të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (25 000, njëzetë e pesë mijë) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

#### **NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

#### **NENI 7 - ORGANET DREJTUESE**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është **Marjon Gorica**, lindur në Tiranë më 01.02.1995 shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. 032043718, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

#### **NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 11**



Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 12 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**


Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**


Akt i Themelimit hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

#### **ORTAKËT**

**Ilir QAFA**



**Faik GËRXHI**



**Marjon GORICA**

